

# DITARI MUJOR <sup>GUSHT</sup> 2024



## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Gjatë muajit gusht u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) të Shqipërisë dhe Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale (AMMKM) të Kosovës.

Nënshkrimi i këtij memorandumi synon përmirësimin dhe thellimin e bashkëpunimit në fushën e restaurimit dhe konservimit të objekteve të trashëgimisë kulturore, në mënyrë të veçantë objekteve të cilat kanë shërbyer gjatë luftës së fundit në Kosovë, si dhe objekteve të cilat AMMKM e Kosovës ka interes për të restauruar dhe konservuar për ruajtjen dhe promovimin historik të tyre.

IKTK dhuroi për arkivin e AMMKM, Revistat "**Monumentet**" dhe "**Arkeologjia**", me qëllim pasurimin dhe shkëmbimin në rritjen e kapaciteteve në fushën e restaurimeve.



# KISHA E SHËN MËRISË MAMURRAS



**Kisha e Shën Mërisë në Mamurras**, një perlë e trashëgimisë kulturore dhe historike të Kurbinit, ndërtuar rreth shekullit XI, e ku Gjergj Kastrioti e Donika thuhet e vizitonin për meshë apo kremtimin e ceremonive fetare.

Ky objekt i shenjtë, një dëshmi e epokës bizantine, pas dëmtimit nga tërmeti i vitit 2019, falë partneritetit të MEKI-it me EU4Culture dhe UNOPS, është kthyer tashmë në një gur themeli të një lulëzimi të ri, përmes një turizmi të qëndrueshëm në gjendje për të prodhuar mirëqënie për të gjithë zonën.

Po përpos vlerave të jashtëzakonshme historike e kulturore, ky vend ka një tjetër trashëgimi unike shqiptare, atë të harmonisë ekzemplare midis besimeve fetare.



# XHUBLETA


## NËN MBROJTJEN E UNESCO-S

**Xhubleta**, nën mbrojtjen e UNESCO-s si një gjest mbijetese dhe përkujdesje ndaj kulturës sonë kombëtare, me vlera të pasura e të patjetërsueshme, që vjen e shpalosur në të gjitha dimensionet e saj në festivalin tradicional ‘Logu i Bjeshkëve’, në Qafë Predeleci.

Ky kostum dhe dije bërja e tij ka udhëtuar gjatë në kohë, duke dëshmuar gjurmët e qytetërimit ilir në trevat dhe kulturën shqiptare, të cilët e dizenjnin atë në mënyra të ndryshme, në dukje të bukura, por që në vetvete krijojnë simbolika që na sjellin mesazhe të cilat ende dhe sot një pjesë prej tyre nuk mund ti dëshifrojmë dot lehtësisht.



# PARKU ARKEOLOGJIK BYLIS



Miratohet vendimi i Këshillit të Ministrave për Planin e Menaxhimit të Parkut Arkeologjik të Bylisit dhe Klosit (2024-2029), 6.25 milionë euro, qendër vizitorësh, muze, vende të reja pune, infrastrukturë prezantimi, konservimi trashëgimie dhe mjedisi!

Vëmendja dhe përkushtimi i MEKI-t, këtë rradhë, u fokusua tek Parku Arkeologjik i Bylisit dhe Klosit, në zëmër të Mallakastrës. Parku arkeologjik dhe plani i tij i menaxhimit, mbështetet nga projekti: "BE për Zhvillimin Ekonomik – Zhvillim Ekonomik Lokal i Udhëhequr nga Turizmi me Fokus në Trashëgiminë Kulturore."

Plani përfshin vijimin e hulumtimeve dhe gjermimeve arkeologjike si edhe investime në punime civile e rrugë aksesi. Ky plan veprimi i drejtuar nga MEKI dhe institucionet e specializuara të tij, do të mbështetet në partneritetin e financimet e BE-së dhe zbatimin e Agjencisë Italiane për Bashkëpunim e Zhvillim (AICS).

Vizioni dhe qëllimi i planit të menaxhimit janë hartuar si vazhdimësi e punës shkencore dhe gjermimeve arkeologjike shumëvjeçare të realizuara nga Instituti i Arkeologjisë (IA) si dhe të punimeve konservuese e restauruese të kryera nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK) dhe institucioneve të tjera të MEKI.



Sitet tona kulturore kanë mirëpritur plot 651,796 vizitorë gjatë Janar-Korrik 2024! Një rritje prej 42% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ku 23% e vizitorëve janë turistë të huaj! Top 5 destinacionet e preferuara të vizitorëve janë:

- Kalaja Gjirokastrër - 120,723 vizitorë
- Muzeu “Gjergj Kastrioti” Krujë - 90,955 vizitorë
- Parku Arkeologjik Shkodër - 85,806 vizitorë
- Parku Arkeologjik Butrint - 84,742 vizitorë
- Parku Arkeologjik Apolloni - 68,469 vizitorë

158,511 vizitorë në kala dhe monumentet e tjera kulturore gjatë Janar-Korrik 2024, 42% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023.

Listën e kalave dhe monumenteve më të vizituar e kryeson kokëllartë dhe krenare, Kalaja e Gjirokastrës me 120,723 vizitorë!

Shpirti i Shqipërisë është i gjallë në këto monumente, ku historia takohet me të tashmen dhe përcillet ndër vizitorët dhe brezat e të ardhmes!



# MUZEU ENTOGRAFIK I KAVAJËS



Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore mori pjesë në vizitën në **Muzeun Etnografik të Kavajës**, e organizuar nga UNOPS EU4Culture Albania. Vizita u zhvillua gjatë fushatës së konservimit, e cila u ndërmor në bashkëpunim me Institutin e Konservimit të Universitetit të Arteve të Aplikuara në Vjenë. Gjatë këtij takimi u njohëm nga afër me proceset e ruajtjes së artefakteve, muzealizimit, dhe me rezultatet e suksesshme të restaurimit të godinës.

# PARKU ARKEOLOGJIK I APOLONISË

Misioni arkeologjik shqiptaro-francez po zhvillon aktivitetin e tij në Parkun Arkeologjik të Apolonisë përgjatë muajit gusht.

Aktiviteti kryesor është përqëndruar në studimin e materialit arkeologjik dhe të disa prej monumenteve të qytetit, siç janë fortifikimi dhe portat hyrëse si dhe “termat” e periudhës romake.



Përdorimi i metodave multi-disiplinore si survejimet gjeofizike, rievimet topografike, si dhe fotogrametritë dhe ortofotot e realizuara pothuajse në të gjithë sipërfaqen e qytetit, kanë nxjerrë në dritë urbanizmin e plotë të Apolonisë së Ilirisë.

Ky projekt jetëgjatë i Institutit të Arkeologjisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme Franceze dhe Shkollave franceze të Athinës (Efa) dhe Romës (Efr), me miratimin e IKTK - MEKI, është kontribuesi kryesor i njohjes së jetës mijeravjeçare të Apolonisë.

# PROJEKTE RESTAURIMI

Falë programit të #EU4Culture në pikturën murale të **Kishës së T'Shëlbuemit** në Rubik po kryhen punime konservuese/ restauruese. Specialistët e Sektorit të Veprave të Artit në IKTK inspektuan nga afër ecurinë e këtyre punimeve të cilat po kryhen nga restauratorja Edlira Çaushi dhe ekipi i saj.


Ndërhyrjet në pikturën murale konsistojnë në:

- konsolidimin e pelikulit piktorik,
- ringjithjen e shtresave përgatitore,
- zbulimin e pikturave murale në faqet veriore dhe jugore nga mbivëniet me llaç dhe gëlqere,
- pastrimin e sipërfaqes së pikturuar nga depozitimet e qëndrueshme,
- integrimin estetik për përmiresimin e të gjithë imazhit të kësaj pikturë.





# SONDAZHE ARKEOLOGJIKE NË GJURMËN E “PORTËS ARKEOLOGJIKE”, BUTRINT



SH 1:1000 TOPOGRAFIA		SH 1:2000 ORTOFOTO			
Nr.	N	E	Nr.	N	E
1	4399955.694	415931.434	8	4399906.552	415935.971
2	4399950.539	415927.282	9	4399894.29	415929.506
3	4399955.588	415943.555	10	4399985.286	415938.435
4	4399949.276	415946.679	11	4399998.939	415936.307
5	4399935.637	415944.591	12	4400019.019	415831.902
6	4399938.647	415938.293	13	4400026.579	415929.219
7	4399915.588	415930.422			

Sistemi Koordinativ : UTM WGS84N

Struktura e portës arkeologjike do të mbështetet mbi një sërë kollonash druri me bazament betoni i cili futet nën tokë në një thellësi prej 80 cm. Duke qënë se vendndodhja e këtij objekti qëndron në afërsi të mureve rrethuese të qytetit antik, zonë e cila paraqet potencial dhe pritshmëri të lartë arkeologjike, është propozuar:

- Realizimi i 9 sondazheve arkeologjike në zonën ku do të ndërtohet objekti "Porta Arkeologjike" dhe 4 sondazhe në zonën ku do të ndërtohet ura panoramike. Sondazhet janë menduar të kryhen në këto zona pasi paraqesin një potencial të lartë arkeologjik dhe projekti parashikon ndërhyrjen në nëntokë.
- Sondazhet do të jenë në formën e një transheje dhe katrore, me përmasat : (3m gjerësi x 5m gjatësi x 1m thellësi), si dhe (3m gjerësi x 3m gjatësi x 1m thellësi).
- Në rastet kur për arsye të ndryshme një nga sondazhet nuk mund të realizohet, të jetë i mundur spostimi i tij, me qëllim kontrollin sa më të gjerë të kësaj zone.

# PROJEKTE KËRKIMORE-SHKENCORE NË VAZHDIM

Ekspedita kërkimore arkeologjike “SAPPA 2024”, ka për qëllim evidentimin dhe dokumentimin e monumenteve arkitektonike- arkeologjike në zonën ndërmjet grykëderdhjes së Lumit Gjadër dhe fshatit Nënshat.

Vazhdimi i kërkimeve arkeologjike lejon njohjen e fazave të ndërtimit dhe përdorimit të këtyre monumenteve.

Në kuadër të kërkimeve shkencore dhe projekteve në terren të Institutit të Arkeologjisë, parashikohet:

- Vazhdimi i kërkimeve arkeologjike në Gropën e Sharrave.
- Sondazh gjurmimi në Castrum Satti mbi Malin e Bardhë.
- Sondazh gjurmimi në lagjen Lekokaj.



Lekokej

Varreza e Hajmelit  
Castrum Satti

Menglla

Krronza  
Fushë Turra

Gropa Sharrave






# PROJEKTE KËRKIMORE-SHKENCORE NË VAZHDIM

“Gërmime sondazhi Orenjë”, (Librazhd).

Objektivi i projektit:

- Sondazh gërmimi në fortifikimin e Orenjës;
- Studimi i materialit arkeologjik për periudhën prehistorike;
- Të kuptojmë karakterin dhe funksionin e këtij fortifikimi, kronologjinë, skemën planimetrike dhe raportin hapësinor midis fortifikimit dhe vendbanimit përkatës, lëvizjen e këtyre fortifikimeve në kohë dhe hapësirë, në kontekst të zhvillimeve historike e kulturore ballkanike e rajonale, gjatë kohe;
- Pozicioni gjeo-topografik i fortifikimit, rilevimi topografik, planimetria e fortifikimit, teknika e ndërtimit, foto me dron etj.



# PROJEKTE KËRKIMORE-SHKENCORE NË VAZHDIM

Në kuadër të projektit “**Harta Arkeologjike Nënujore e Bregdetit Shqiptar**”, janë parashikuar këto kërkime në terren:

a- Kërkime në Gjiun e Durrësit dhe atë të Vlorës.

b- Kërkime në Liqenin e Ohrit dhe të Prespës.

c- Dokumentim i guroreve antike në Gadishullin e Karaburunit në Gjiun e Vlorës.

Qëllimet shkencore të projektit:

- Për vitin 2024, pritet të rritet sipërfaqja nënujore e kërkimeve arkeologjike në Gjiun e Durrësit, Liqenet e Ohrit dhe Prespës.
- Të plotësohen të dhënat batimetrike në veri të portit të Durrësit dhe të integrohen me të dhënat gjeomorfologjike të bregut të detit në këtë zonë.
- Të vazhdojë dokumentimi grafik, fotografik dhe video i siteve prehistorike, në liqenet e Ohrit dhe të Prespës.
- Do ndërtohet modeli dixhital i terrenit në sitet LIN 1, Udënisht dhe Prespa 1.
- Do të ndërtohet orto-foto për sitet Lin 1, Udënisht dhe Prespa 1.
- Do ndërtohet modeli dixhital i terrenit në sitet e guroreve antike në Gadishullin e Karaburunit, Mermeri, Gjiu i Gramës.
- Do të ndërtohet Ortofoto për sitet e guroreve antike në Gadishullin e Karaburunit, Mermeri, Gjiu i Gramës.
- Në Gjiun e Durrësit do të vazhdojnë zhytjet e thellësive të mëdha mbi 100m me mishela gazi.

